



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.05.2022

MBLEDHJA Nr. 20,
Datë 09.05.2022, ora 11:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 09.05.2022, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 20 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 28.04.2022
2. Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollojnë interesat e shoqërisë “Albesh Trading & Consulting” sh.p.k.
3. Mbi rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.02.2022, “Mbi ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Sekë” me kapacitet të instaluar 12667 kW dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kW, me kapacitet total të instaluar 14962 kW”
4. Mbi licencimin e shoqërisë "Karavasta Solar" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me vendndodhje në zonën e Remasit -Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 MWp
5. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “H&K@VALA MAR Residences” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
6. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Duferco Shqipëria” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
7. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., me nr. 372 seria F12/17 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.07.2012, i ndryshuar

8. Mbi kërkesën e shoqërisë “Alb - Energy” sh.p.k., për rinovimin e licencës nr. 367, seria T17, në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 11.05.2017
9. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.03.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 MW”
10. Mbi shtyrjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s lidhur me kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës nr. 49, seria NPM07P dhënë me vendimin e bordit nr. 61, datë 02.11.2007, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, i ndryshuar
11. Mbi kërkesën e shoqërisë “Hydrocentrali Cangonj” sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nr. 210, seria PV13K, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 01.10.2013
12. Çështje të tjera

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI